

Prof.dr. Exhlale DOBRUNA-SALIHU

RËNDËSIA E LUMIT DANUB PËR IMPORTIN E SKULPTURËS NË DARDANI NGA AZIA E VOGËL

Dardania, si pjesë e territorit të gjerë ilir edhe pse bënte pjesë në trevat e brendshme të tij, kishte një pozitë të volitshme gjeografike, meqë përmes luginave të lumenjve Axios (Vardar), Drinus (Dri) dhe Margus (Moravë Jugore), me të cilën lidhej me lumin Danubius (Danub), lidhej me tri botëra të rëndësishme: në jug me Egjeun, në perëndim me bregdetin ilir të Adriatikut dhe në lindje me trevat e Detit të Zi dhe të Mesdheut. Rrjedhat e tyre, që në parahistori, kanë diktuar edhe drejtimin dhe karakterin e rrugëve kryesore, nëpërmes së cilave ka vënë kontaktet me trevat e cekura.

Nga aspekti i rrugëve lumore, megjithëse Danubi nuk i takonte Dardanisë, duke u lidhur me këtë trevë edhe përmes lumit Timacus (Timok), me lundrueshmërinë e tij në të gjithë rrjedhën gjithsesi gjatë kohës romake zinte një vend me rëndësi. Rëndësia e tij e madhe në Perandorinë Romake më së miri ilustron me ndërtimin e rrugës së Gjerdapit Viminacium – Ratiaria e filluar në deceniet e para të shek. I., nën Tiberin, për nevoja jo vetëm ushtarake, por edhe për sigurinë e lundrimit nëpër këtë lum.¹ Ai në Dardani ka luajtur një rol me rëndësi për importin e skulpturës dhe blloqeve të mermerit nga Azia e Vogël dhe rajonet tjera të Mesdheut. Kjo më shumë është e shprehur në qendrat veriore dardane: vendbanimin dhe stacionin Timacum minus (Ravne), i cili me Danubin lidhej përmes Timakut (Timokut të Bardh e të Zi) – gjithashtu i rëndësishëm për transport.² – dhe municipin Naissus (Nishi), i cili lidhej me rrugën e njëjtë dhe Margun. Megjithëse të dy këto qendra me Danubin lidheshin edhe me rrugën Naissus-Ratiaria³, ky import realizohej përmes rrugëve lumore. Në Timak minus një grup i skulpturës së kultit të Panteonit greko-romak dhe atij oriental, kryesisht i kualitetit të lartë – i gjetur në tempullin e Jupiter Dolikenit (Dolicheneum) në afërsi të kastrumit⁴ – me llojin e mermerit, i cili në pjesën më të madhe është i prejardhjes së Azisë së Vogël, duhet të ishte i importuar nga kjo trevë, ose edhe i punuar në punëtoritë lokale.

1 Khr. P. Petrović, *Niš u antičko doba*, Niš 1976, 89-90.

2 P. Petrović, Timacum Minus et la vallée du Timok, *Inscriptions de la Mésie Supérieure (IMS)* 3 2, Beograd 1995, 19-21.

3 P. Petrović, *Niš...*, 89: 106-110; i njëjti, Naissus-Remisiana-Horreum Margi, IMS 4, 1979., 20, 26; i njëjti, Timacum minus..., 23-24.

4 P. Petrović, Timacum minus..., 42, shën. 26, 50, i cili shpreh mendimin se ekziston mundësia që të gjithë ekzemplarët i kanë sjellë ushtarët nga Lindja.

Kurse në arealin e Naisit nga kjo trevë është bartur mermeri i kualitetit të lartë për punimin e një numri të vogël të shtatoreve të kultit të Panteonit vendas dhe atij greko-romak, ndërsa nga një trevë tjetër, Egjipti, janë importuar tri realizime skulpturore në porfir të cilat janë bartur përmes detit Mesdhe dhe të Zi⁵. Ndërkaq, duke u nisur nga fakti se grekët edhe gjatë kohës romake monumentet dhe mermerin e transportonin edhe me qerre tërheqëse⁶, atëherë skulptura e kësaj qendre nga mermeri atik⁷ mund të bartesh edhe me rrugë më të shkurtra – deri te Tesaloniku përmes detit, për të vazhduar me rrugën e njohur tokësore Thesaloniki-Scupi-Naissus⁸ që posaçërisht ju kanë përgjigjur statuetave, të cilat përbënin pjesën më të madhe të saj. Nga pjesët tjera dardane, këtij importi i takojnë dy sarkofagë të kualitetit të lartë nga pjesa qendrore (Kosova), njëri si gjysmëfabrikë dhe tjetri si prodhim i gatshëm.

Ne këtu do ta trajtojmë vetëm skulpturën e importuar nga Azia e Vogël, e cila u përket dy grupeve të mëdha tematike: të kultit dhe mbivarrore.

*

Skulptura e kultit – është më e numërta. Të gjithë ekzemplarët janë fragmentarë, ku në numrin më të madh janë ruajtur statuetat pa kokë apo vetëm kokat e tyre, kurse shumë rrallë torzot dhe bazamentet.

Ekzemplarët e arealit të Naisit i përbëjnë dy shtatore të perëndeshave të gjetura në lokalitete të ndryshme të këtij areali.

Njëra shtatore është gjetur në peristilin e pallatit (vilës) së kohës së vonë romake në Mediana (Bërzi Brodi). Përafërsisht e gjatësisë natyrore, 134 cm, është punuar në mermer kualitativ kristalor⁹ (fig. 1). Trupi i perëndeshës, e cila paraqet hyjninë kryesore dardane, Deae Dardanicae,

5 Një kokë portretore nga Naisi e publikuar nga D. Srejić, Dva kasnoantička portreta iz Srbije, *Živa antika* (ŽA) 9/1-2, Skopje 1959, 253 e tutje, fig. 1; kurse interpretimi për vendin e prodhimit dhe identifikimin e saj me Konstantinin I nga: Zs. Kiss, *Etudes sur le portrait Imperial romain en Egypte*, Varsovie 1984, 97-100, 102; M. Tomović, *Roman Sculpture in Upper Moesia*, Beograd 1993, 57. Dy statua kultit të Panteonit grek nga Mediana të publikuara nga A. Jovanović, Neki aspekti problema skupnog nalaza skulpture sa Medijane kod Niša, *Starinar* 24-25, 1973-74, Beograd 1975, 57, n. 1, T. 2, fig. 2, 57-58, n. 2, T. 3, fig. 4; kurse interpretimi për rrugën e importit nga: P. Petrović, Naissus..., 1979., 97; M. Tomović, po aty, 22, 57, 98; E. Dobruna-Salih, *Plastika dekorative dhe figurative e gurit në Dardani gjatë kohës romake* 1-2, Prishtinë 2003-2005, 534-537, 540-542.

6 R. S. Stainer, The cost of the Parthenon, *The Journal of Hellenic Studies* 73, London 1953, 68 e tutje.

7 Khr. A. Jovanović, vep. cit., 57 e tutje (statuetat e kultit); G. Koch, Ein Sarkophagfragment mit dem Kampf bei den Schiffen, *Journal J. Paul Getty Museum, Occasional Papers Antiquities* 6-7, Malibu 1978-1979, 106-107, n. 15, fig. 3; E. Dobruna-Salih, Kaiserzeitliche reliefgeschmückte Sarkophage aus Dardanien, *Thiasos. Festschrift für Erwin Pochmarski zum 65. Geburtstag*, Wien 2008, 179, fig. 5 (sarkofagu); *Antički portret na ilu Jugoslavije*, Beograd 1984, 211, n. 174, 212, n. 176 (dy koka portretore).

8 Për këtë rrugë khr.: K. Miller, *Itineraria Romana*, Stuttgart 1916., 555-556; N. Vulić, Teritorija rimskog Skoplja, *Glasnik Skopskog naučnog društva* 1, Skopje 1925, 1-4; P. Petrović, *Niš...*, 1976, 103-105; i njëjti, Naissus..., 27-29 me literaturën tjetër.

9 N. Vulić, Antički spomenici naše zemlje, *Spomenik akademije nauka i umtenosti*, Beograd 1941-48, 109, n. 237; E. Dobruna-Salih, *Plastika dekorative*, 859, n. 406, T. 188, fig. 351 (me literaturën e cituar).

rëndon mbi këmbën e majtë, ndërsa e djathta e përkulur në gju, tërhiqet pak prapa. Është e veshur me hitonin e gjatë që i mbulon tërë trupin, pos llërës së dorës së djathtë dhe pëllëmbës së dorës së majtë. Ai është shtrënguar nën gjinj me një brez dhe duke krijuar një kolpos të kthyer deri në kofsha, zbrit deri në fund të këmbëve të mbathura me këpucë, duke lënë zbuluar vetëm majat e tyre. Mbi kokë ka hedhur një shami të madhe e cila duke i mbuluar supet dhe shpinën, bie deri në tokë. Në llërën dhe pëllëmbën e mbledhur të dorës së djathtë, të lakuar në bërryl e të vendosur në gjoks, mban një gjedh, ndërsa në të majtën të lëshuar poshtë ngjit për trupi, mban qesen (marsupium). Përbri këmbës së majtë në një reliev të thellë është skalitur koka e derrit të egër, kurse mbi të sëpata dyteheshe (labrys).

Kjo shtatore, përkundër trajtimit të rregullt të pjesëve lakuriqe të të dy duarve dhe detajeve anatomike, të cilat i karakterizon cilësia e lartë e punimit është modeluar në mënyrë dydimenzionale dhe frontale. Kjo sidomos është e theksuar te palat në veshje, të cilat janë lineare dhe kryesisht bien në mënyrë vertikale dhe simetrike, ku e mesmja është më e theksuara, e cila, duke rënë nga prerja e jakës deri në fund të këmbëve, e ndan shtatoren në dy pjesë simetrike. Në bazë të kësaj paraqitje të veshjes dhe veçorive tjera stilistike kjo shtatore lidhet me ato të perëndeshave në peplos nga koha e vonë helenistike, (shekujt II – I p. Kr.)¹⁰, duke treguar se modelin e saj duhet kërkuar në atë drejtim¹¹. Shikuar nga ky aspekt më së shumti tregon ngjashmëri me dy shtatore të Herës, sidomos me atë nga ujdhesa Samos, së cilës i përgjigjet edhe pozicioni i vetë shtatores me peshën e trupit mbi këmbën e majtë¹². Mirëpo, për nga mënyra e punimit të veshjes, ku palat janë trajtuar me kanelyra të gjera, kjo shtatore u përgjigjet veprave skulpturore të Antikitetit të Vonë, duke i takuar kështu çerekut të parë të shekullit IV, që është vërtetuar edhe me material numizmatik¹³. Sa i takon vendprodhimit, edhe pse në mermer të huaj, me gjasë u punua në punëtorinë lokale¹⁴, gjithsesi nga dora e ndonjërit nga skulptorët e huaj, më parë të qendrave lindore, të cilët në atë kohë vepronin në punëtorinë e Naisit¹⁵.

Nga aspekti i identifikimit të personit të paraqitur, përkatësisht të perëndeshës, kjo shtatore e cila i takon tipit të matronës – gruas në moshë

10 Khr. L. Beschi, Demeter. *Lexicon Iconographicum Mythologiae Classicae*. Zürich-München (LIMC) 4 1. 1988. 852-855; LIMC 4 2 566-569 (shtatore e Demetrës).

11 Khr. D. Srejović – A. Ceranović-Kuzmanović. *Rimska skulptura u Srbiji*. Beograd 1987. 134.

12 A. Kossatz-Deissmann. Hera. LIMC 4 1. 1988. 675. nn. 133 a. 135; LIMC 4.2. 411. fig. 133 a (nga Museu i Vatikanit). 412. fig. 135 (nga Samosi).

13 Khr. A. Jovanović. Prilog proučavanju skulptura sa Medijane. *Niški zbornik* 9. Niš 1980. 57.

14 P. Petrović. Niš... 148. fig. 62 me të cilin janë pajtuar edhe studiuesit e mëvonshëm.

15 Khr. D. Srejović – A. Ceranović-Kuzmanović. vep. cit., 10; M. Tomović. vep. cit., 32; E. Dobruna-Salihu. *Plastika dekorative...* 598; e njëjta. Stone-carving Workshops in Dardania. *Les ateliers de sculpture régionaux: techniques, styles et iconographie*. Actes du X Colloque International sur l'Art Provincial Romain (Arles et Aix-en-Provence, 21-23 Mai 2007) Arles et Aix-en-Provence 2009. 311.

të pjekur, ka qenë diskutabile një kohë të gjatë. Mirëpo, që nga studiuesit e mëhershëm është interpretuar si një perëndeshë vendëse, lokale, me veti sinkretike, të cilën Ch. Picard e njëson me Kibelën¹⁶. Mendime të ngjashme kanë edhe studiuesit e mëvonshëm, kështu që nga ana e P. Petroviqit është identifikuar me një perëndeshë autoktone të bujqësisë dhe të gjetisë me funksione të Kibelës dhe të Dianës¹⁷. Kurse A. Jovanoviçi në një punim të tij më të hershëm këtë figurë e interpreton si paraqitje të një perëndeshë sinkretike, e cila ka elemente të Kibeles dhe të Demetrës¹⁸. Por, në një punim më të vonshëm kushtuar vetëm kësaj shtatoreje, ka treguar bindshëm se kjo në fakt është Dea Dardanica, përkatësisht paraqitja e personifikimit të Dardanisë¹⁹, që edhe është pranuar nga studiuesit e tjerë²⁰. Ky studiues saktë ka vërejtur se si model ikonografik për këtë paraqitje me siguri është marrë koncepti i perëndeshës dardane nga një reliev votiv i gjetur në Romula Malva (vendbanimi te Reshka në Olteni) në provincën e Dakisë së Poshtme, kushtuar kësaj perëndeshë me dedikimin “[Da]rdanic(a)e”, ku veshja është gati identike, si dhe pozicioni i dorës së djathtë me gjedh²¹. Dedikantët e këtij relievi janë dy dekurionë me prejardhje nga Dardania, të cilët ia përkushtojnë perëndeshës së atdheut të tyre. Nga kjo kuptohet se kulti i kësaj perëndeshë nga Dardania është bartur në Daki dhe, si e tillë i takon grupit të perëndive/perëndeshave të atdheut (deae patriae), që i hasim në të gjithë Perandorinë (dii-deae Daciarum, Dea Syria etj.)²². Prandaj kjo shtatore paraqet perëndeshën dardane me veti sinkretike nga funksioni, kulti i së cilës në Dardani, pos epigrafikisht, është dëshmuar edhe me tempull²³.

Shtatorja tjetër, ku në fakt kemi të bëjmë me statuetë, është gjetur në Klisurë te Nishi dhe i takon Higisë. E punuar në mermer të bardhë kristalor, me gjatësi 56 cm, në disa pjesë është e dëmtuar²⁴ (fig. 2). I mungon një pjesë e supit të majtë, pjesa e poshtme e hitonit në anën e djathtë dhe të

16 Ch. Picard, *Observations archéologiques en Yougoslavie, septembre 1953, Comptes rendus de l'Académie des Inscriptions*, 1953, 93-94.

17 P. Petrović, po aty.

18 A. Jovanović, *Neki aspekti problema...*, 62.

19 A. Jovanović, *Prilog proučavanju...*, 53-60, posaçërisht 55, 57, fig. 1.

20 D. Srejić – A. Cermanović-Kuzmanović, vep. cit., 134, n. 58; M. Tomović, vep. cit. 94, n. 95; E. Shukriu, *Dea Dardane dhe monumentet e tjera epigrafike nga Smira, Buletin i Fakultetit Filozofik* 26, 1996, Prishtinë 2001, 17-38; E. Dobruna-Salihi, *Plastika dekorative...*, 577-579.

21 D. Tudor – C. Vlădescu, *Dardania la Romula-Malva, Apulum* 10, 1872-1972, Alba Iulia 1972, 184-186, fig. 1; D. Tudor, *Recentele săpături arheologice romane de pe valea Oltulin Inferior, Apulum* 11, 1973, 120-121, fig. 4.

22 D. Tudor – C. Vlădescu, po aty, 188;

23 Në kohë të fundit shih: E. Shukriu, *Deae Dardanae – ikonografia, simbolet dhe funksionet, Kosova*, 26, 2004, Prishtinë 2005, 9-32; E. Dobruna-Salihi, *Pesë monumente të pabotuara nga koleksioni i arkeologjik i antikitetit në Muzeun e Kosovës, Gjurmime Albanologjike – Seria e shkencave historike* 38, 2008, Prishtinë 2009, 242-248, T. 3, fig. 5.

24 D. Srejić – A. Cermanović-Kuzmanović, vep. cit., 156, n. 69; M. Tomović, vep. cit., 97, n. 109, fig. 28/1; E. Dobruna-Salihi, *Plastika dekorative...*, 846, n. 380, T. 176, fig. 325.

dy shputat e këmbëve. Pesha e trupit rëndon mbi këmbën e djathtë, ndërsa e majta është e përkulur lehtë në gju dhe e tërhequr diskret nga prapa. Është e veshur në hiton të gjatë të trajtuar me pala të dendura vertikale dhe himation deri përfundi gjunjëve, i cili i mbështjellë pjesën më të madhe të trupit. pos pjesës së majtë të gjoksit, si dhe të dy duart, duke i lënë të zbuluara pëllëmbët e tyre. Palat e tij, të skalitura thellë ndjekin pozicionin e trupit, ku në anën e djathtë janë të pjerrëta, në mes harkore, ndërsa mbi këmbën e majtë ato humbin meqë këtu himatio—ni puthitet fare duke lejuar të dallohen konturet e saj. Me dorën e majtë, të lakuar në bërryl dhe të ngritur në lartësi të gjoksit, mban bishtin e gjarprit i cili është paraqitur sipërfaqësisht përgjatë skajit të himationit. Në dorën e majtë, të lëshuar poshtë e të mbështetur në ije, mban kokën e gjarprit. Shikuar nga aspekti artistik, trajtimi i gjithëmbarshtëm i kësaj statuete, e sidomos i palave në veshje të modeluara në trajtë kanelyrash, tregon se më parë kemi të bëjmë me një vepër të punëtorisë lokale, e cila sipas cilësive stilistike, duhet të jetë punuar në fund të shek. III dhe fillim të shek. IV²⁵.

Modeli sipas të cilit u punua kjo statuetë, shihet qartë se ka të bëjë me klisenë e njohur të "Herkulanës së Madhe". Mirëpo, meqë ajo ikonografikisht nuk lidhet me paraqitjet e Higisë, por me shtatorët e grave me qëndrim dhe veshje të këtij tipi, të cilat në të shumtën e rasteve paraqesin romaket e klasës së lartë ose perandoreshat²⁶, atëherë skulptori, i motivuar nga ky tip statuar, rreth skajit të mantelit në gjoks e ka shtuar gjarprin. Nga materiali i publikuar që kemi pasur mundësi ta shohim, nuk kemi hasur në shembuj të tillë në trevat e tjera.

Ekzemplarët e Timak minusit i përbëjnë si statuetat e perëndeshave ashtu edhe ato të perëndive.

Njëra statuetë paraqet Venerën e punuar në mermer të bardhë kristalor, nga e cila ka mbetë torzoja e gjatësisë 20cm me dëmtime të gjinjve²⁷ (fig.3). Perëndesha është paraqitur lakuriqe ku një tufë krelash të gjatë flokësh bie në mes të gjinjve, ndërsa dy më të shkurtra në të dy anët e supeve. Trupi, me një këthyerje të lehtë nga e majta, është theksuar shumë mirë me anë të modelimit të ijeve dhe të kofshës së këmbës së majtë. Në bazë të mbetjeve të kofshëve të këmbëve, duket se pesha e trupit binte mbi këmbën e majtë. Kurse sipas mbetjeve relievo në trup, me siguri me dorën e djathtë mbulonte gjinjtë, ndërsa me të majtën pubisin. Shikuar

25 Khr. D. Srejšović – A. Ceromanović-Kuzmanović, po aty, 156.

26 Për tipin e shtatoreve të "Herkulanës së Madhe" shih: M. Collignon. *Les statues funéraires dans l'art Grec*. Paris 1911. 168-170, fig. 99.

27 N. Vulić. *Antički spomenici*.... 92. n. 197; M. Tomović, vep. cit., 88. n. 74. fig. 31 3; E. Dobruna-Sali-hu, *Plastika dekorative*.... 847. n. 382. T. 177, fig. 327.

nga aspekti ikonografik, kjo shtatore paraqet tipin më të popullarizuar dhe të kopjuar shpesh të Afroditës – Venerës lakuriqe të quajtur pudica, që ka dalë nga skulptura e Praksitelit, ku modeli pa dyshim duhet të kërkohet në Afroditën e famshme të Knidit²⁸. Ndërkaq, statueta jonë, sipas pozicionit të duarve e të këmbëve, mbështetet në tipat e Venus Capitolina dhe të Venus Medici, të cilat paraqesin replikat romake të origjinaleve helenistike dhe duke qenë të inspiruara nga Afrodita e cekur e Praksitelit, njëherësh paraqesin edhe variantet më të afërta apo kopjet më të njohura të saj, të cilat janë të përhapura mjaft në të gjithë Perandorinë²⁹. Si e tillë duhet të jetë formuar sipas një modeli të mirë helenistik. Kurse vetëm në bazë të pozicionit të trupit, përkatësisht të modelimit të ijës së majtë, është shumë e afërt me një shtatore nga Galia, e cila sot gjendet në Muzeun e Epinalit (Francë)³⁰.

Punimi i gjithëmbarshtëm i figurinës është cilësor, që shihet në modelimin e drejtë dhe të butë të pjesëve dhe të hollësive anatomike të trupit lakuriq të saj. Sa i takon vendit të punimit, duke qenë se numri më i madh i paraqitjeve skulpturore të Venerës punuar në mermer të bardhë të kualitetit të lartë nga guroret e njohura të Azisë së Vogël ose të rajonit grek në intervalin kohor të fundit të shek. II dhe gjatë shek. III – ku pjesa më e madhe, duke kopjuar modelin e njëjtë, i takojnë tipit të njëjtë – janë nga Viminacium-i (Kostolci) në Mezi të Epërme, mund të thuhet se kryesisht janë prodhim i punëtorisë së kësaj qendre të dala më parë nga duart e skulptorëve vendës³¹. Mirëpo, edhe pse ka gjasë që edhe statueta e Timak minusit të ketë dalë po nga kjo punëtori, meqë për shkak të dimensioneve të vogla lehtë transportohej, megjithatë ka mundur të dalë edhe nga punëtorja e kësaj qendre sipas modelit të njëjtë nga dora e një mjeshtri me mjaft përvojë, duke treguar se edhe skulptorët provincial mund të krijonin vepra cilësore.

Të tre ekzemplarët tjerë, si mbetje të statuetave, disponojmë me tri koka me kalatos. Dy ju takojnë perëndeshave.

28 Për kopjet romake të Afroditës së Praksitelit shih: S. Reinach, *Répertoire de la statuaire grecque et romaine*, Paris 2/1897a, 356, nn. 6-10; i njëjti, 3/1904, 109, n. 6; F. Cumont, *Catalogue des sculptures et inscriptions antiques (monuments lapidaires) des Musées Royaux du Cinquantième*, Bruxelles 1913, 121, n. 94; K. Papaioannau, *Griechische Kunst*, Wien 1972, fig. 808; H. Manderscheid, *Die Skulpturenausstattung der kaiserzeitlichen Thermenanlagen*, Berlin 1981, 74, n. 50, T. 17.

29 Nga literatura e shumtë për këta tipa të Afroditës shih: H. Stuart-Jones, *A Catalogue of the Ancient Sculptures preserved in the Municipal Collections of Rome: I. The sculptures of the Museo Capitolino*, Oxford 1912, 182, n. 1, T. 45; G. Traversari, *La statuaire ellenistica del Museo archeologico di Venezia, Collezioni e Musei Archeologici del Veneto*, Roma 1986, 27-28, n. 5 (tipi Capitolino); V. S. M. Scrinari, *Catalogo delle sculture romane, Museo archeologico di Aquileia*, Roma 1972, 12-13, nn. 31-34 (tipi Medici); A. Delivorrias – G. Berger-Doer – A. Kossatz-Deissmann, *Aphrodite*, LIMC 2/2, 1984, 49-54 (të dy tipat me literaturën e cituar). E para ruhet në Museo Capitolino të Romës, ndërsa e dyta në Galleria degli Uffizi të Firences.

30 E. Espérandieu, *Recueil général des bas-reliefs, statues et bustes de la Gaule romaine* 4, Paris et Bruxelles 1911, 167, n. 4836.

31 M. Tomović, vep. cit., 74-76, 88-89 me katalog.

Njëra kokë, nga mermeri i bardhë i kualitetit të lartë me gjatësi 8,5cm. është e ruajtur me një pjesë të qafës, ndërsa kalatosi gadi është i thyer tërësisht³² (fig. 6). Përkundrazi, fytyra është ruajtur mjaft mirë, përpos dëmtimeve të vogla në majë të hundës dhe në vetulla. Ajo ka trajtë rumbullake me simetri të theksuar në modelimin e tipareve. Sytë e mëdhenj, me bëbe të trajtuar me burgji (trapezage), janë të thelluar, vetullat e holla harkore, hunda e drejtë, goja e vogël me buzën e poshtme më të plotë dhe mjekra shumë e theksuar. Kjo fytyrë e trajtuar në këtë mënyrë, me shikim të ftohtë dhe të shtanguar, i jep asaj një shprehje të ashpër. Në krahasim me fytyrën, flokët janë modeluar më lirshëm. Ata janë të ndarë në mes dhe janë krehur në tufa të mëdha të skalitura mjaft thellë në të dy anët e kokës në mënyrë simetrike dhe, duke mbuluar pjesërisht veshët, lidhen prapa në zverk. Për shkak të përdorimit të burgjisë, në mes të këtyre tufave krijohen hije të thella. Përkundrazi, sipërfaqet e fytyrës janë të qeta dhe pa lëvizje.

Te koka tjetër me gjatësi 9cm mungon qafa, ndërsa kalatosi është i ruajtur në tërësi³³ (fig. 7). Sipërfaqja e fytyrës në disa vende është e gërryer, ndërsa një dëmtim më të madh e ka në gojë. Edhe pse nga aspekti stilistik i afrohet ekzemplarit të mëparshëm, janë të pranishme disa ndryshime në mënyrën e modelimit në përgjithësi, e lidhur me të edhe në shprehjen e gjendjes shpirtërore. Kështu, fytyra ka faqe të mbushura dhe tipare të trajtuara më butë, kurse flokët, të cilët edhe pse janë të krehur në mënyrë të njëjtë, tufat e përdredhura i kanë më të vogla. Një trajtim i tillë fytyrës i jep një shprehje më të butë dhe të këndshme, me një dozë pikëllimi në shikim.

Këto koka janë interpretuar në mënyra të ndryshme. Sipas një mendimi që të dyja janë identifikuar si koka të perëndeshës kryesore egjiptiane – Izidës³⁴ ndërsa, sipas mendimit tjetër, koka e parë është identifikuar me Fortunën romake, por prapë si hipotetike³⁵.

Identifikimin e këtyre kokave, në fakt, sa e lehtëson, aq edhe e vështirëson prania e kalatosit, meqë e hasim te paraqitjet figurative te të dy këtyre perëndeshave. Mirëpo, derisa te Fortuna është pa ndonjë shenjë të veçantë³⁶, te Izida i ka brirët e gjedhëve, përkatësisht zbukurimin në trajtë të gjysmëhënës dhe diskun diellor³⁷. Lidhur me këtë element është me rëndësi të ceket se Fortuna është njësuar me Izidën, ku me simbiozën

32 N. Vulić, vep. cit., 92, n. 199; E. Dobruna-Salih, *Plastika dekorative...*, 855, n. 399, T. 184, fig. 344 (me literaturën e cituar)

33 N. Vulić, po aty, 92, n. 200; E. Dobruna-Salih, po aty, 856, n. 400, T. 184, fig. 345 (me literaturën e cituar).

34 Lj. Zotović. Les cultes orientaux sur le territoire de la Mésie Supérieure. *Études préliminaires aux religions orientales dans l'Empire romain*, publiées par M. J. Vermaseren. Leiden 1966, 103-104, nn. 47-48.

35 D. Srejšević – A. Cermanović-Kuzmanović, vep. cit., 102, n. 42; M. Tomović, vep. cit., 89, n. 82.

36 Khr. S. Reinach, vep. cit., 1897a, 242, nn. 5.7. 243, nn. 1, 3, p. 262, nn. 1, 2, 4, 5, p. 263, nn. 1, 2; V. S. M. Scrinari, vep. cit., 51-52, n. 144, fig. 145, n. 148, fig. 152, n. 151, fig. 151.

37 Khr. S. Reinach, po aty, 363, n. 8.

e tyre formohet një perëndeshë sinkretike e re Isis-Fortuna³⁸. Meqë kemi të bëjmë vetëm me koka, atëherë është vështirë të themi saktësisht se cilën perëndeshë e paraqet koka e parë, Izidën egjiptiane apo Fortunën romake. Në këtë rast mund të na ndihmojë vendndodhja e kokës dhe ekzemplarët e skulpturave të ngjashme në fqinjësinë më të afërt. Duke u bazuar në këto të dhëna, në një anë, mund të orientohemi për Izidën, meqë që të dy kokat janë zbuluar së bashku me kokën e perëndisë egjiptiane, Serapisit. Në anën tjetër, mund të orientohemi edhe për Fortunën, për të cilën kemi edhe më shumë fakte. Në radhë të parë, pos mënyrës së modelimit, i cili i përgjigjet kësaj perëndeshë, në qendrën e afërt të Timak minusit, në Montana (Mihajlovgradi) të Mezisë së Poshtme, po ashtu, është gjetur koka e kësaj perëndeshë, e cila është e punuar në stilin e theksuar provincial³⁹, si dhe një statuetë e punuar në mënyrë të ngjashme në Viminac⁴⁰. Një gjë tjetër që po ashtu shkon në dobi të saj është dëshmia epigrafike në të gjithë trevën dardane⁴¹. Mirëpo, me gjithë praninë e këtyre fakteve, të cilat flasin për nderimin e kultit të kësaj perëndeshë në trevën dardane, deri te zbulimet e reja në fushë të plastikës, nuk mund ta themi fjalën përfundimtare për identifikimin e kësaj koke.

Mënyra e punimit të të dy kokave tregon qartë se janë vepra të skulptorëve profesionalë, sidomos ai i kokës së parë pa dyshim ishte i nivelit të lartë, që bazuar në vetitë stilistike, duhet të jenë punuar në fund të shek. III dhe fillim të shek. IV⁴². Sa i takon vendit të prodhimit, koka e parë si dhe statueta në tërësi paraqet import të sigurtë nga një punëtori e nivelit të lartë nga Lindja. Kurse për kokën tjetër, edhe pse vendi i gjetjes flet se edhe kjo statuetë duhet të jetë sjellë nga Lindja, humbja e saj e vështirëson konstatimin e vendit të prodhimit, madje mund të bëhet se është vepër e skulptorit të punëtorisë lokale.

Koka e tretë me gjatësi 13,5cm, i takon Serapisit. Përveç dëmtimeve të mjekrës, është e ruajtur mirë⁴³ (fig. 8). Ka fytyrë në trajtë vezake me tipare të theksuara. Sytë me trajtë bajameje po ashtu e kanë të skalitur edhe beben, e cila me një pjesë mbulohet nga kapakët e sipërm më të trashë, duke u dhënë syve një pamje të prirur përpjetë⁴⁴. Mbi ta, me vija të lehta,

38 Khr. P. Lisičar, Isis-Fortuna. Spomenici kultu Izide, Fortune i Izide-Fortune u našoj zemlji, *Starinar* 12, Beograd 1961, 125 e tutje. Por në trevën dardane deri tash nuk është gjetë asnjë dedikim epigrafik, i cili do të dokumentonte këtë perëndeshë sinkretike.

39 G. Aleksandrov, Rezultati ot raskopite na krepostu Montana (1971-1982), *Montana* 1, Sofija 1978, 54 e tutje, fig. 26.

40 D. Srejšović – A. Cermanović-Kuzmanović, vep. cit., 88, n. 35.

41 Khr. Z. Mirdita, Antroponimia e Dardanisë në kohën Romake, Prishtinë 1981, 213 e tutje (me literaturën e cituar).

42 Khr. Lj. Zotović, vep. cit., 103-104; D. Srejšović – A. Cermanović-Kuzmanović, po aty, 102.

43 N. Vulić, vep. cit., 92, n. 198; E. Dobruna-Salihu, *Plastika dekorative...*, 856, n. 401, T 185, fig. 346 (me literaturën e cituar).

44 Për mënyrën e trajtimit të syve në skulpturat e Apolonisë, khr. F. Prendi – H. Ceka, *Skulptura të Apolonisë*, *Studime historike* 2, Tiranë 1964, 35, n. 8, T. 9/1, 42, n. 12, T. 12.

janë skalitur vetullat. Hunda është e drejtë dhe e gjatë, goja e madhe me buzën e poshtme më të theksuar. Flokët, e modeluar lirshëm në tufa krelash të mëdha, bien në të dy anët e kokës, duke e lënë ballin e zbuluar dhe rrethuar fytyrën, ku në qafë bashkohen më mjekrën e modeluar në të njëjtën mënyrë, mbi të cilën janë të theksuara mustaqet e dendura dhe të gjata me skaje të dredhura, që është e zakonshme edhe tek ekzemplarët e qendrave të tjera⁴⁵. Tufat e flokëve janë trajtuar me skalitje të thellë me ndihmën e burgjisë, me ç'rast është krijuar efekti i theksuar i sipërfaqeve të ndriçuara dhe të errëta. Me këtë detaj u afrohet dy kokave të mëparshme, sidomos kokës së parë. Këto tipare fytyrës i japin një pamje madhështore dhe të qetë, por me shikim të ftohtë e pikëllues, duke treguar ngjashmëri me të dy kokat e perëndeshave, në bazë të së cilës edhe kjo kokë, përkatësisht e gjithë statueta duhet t'i takojë fundit të shek. III⁴⁶.

Mënyra e krehjes së flokëve, të cilët, duke e lënë ballin të zbuluar, bien në të dy anët e tij me dy përdredha në mes, si në rastin tonë, është karakteristikë e paraqitjeve të Zeusit të tipit Otricoli⁴⁷. Shikuar nga ky detaj ikonografik, ekzemplari ynë është i ngjashëm me kokën e Serapisit nga Akuileja, të datuar në gjysmën e dytë të shekullit II, e cila paraqet elaborimin e tipit të marrë nga modelet atikase në fund të shek. II p. Kr.⁴⁸. Mirëpo, në mes të tyre janë të pranishme ndryshimet e dukshme stilistike. Koka jonë po ashtu është e ngjashme edhe me një kokë nga Stobi të datuar në fundin e shekullit II⁴⁹, por me disa ndryshime në detaje. Balli i kësaj koke është i mbuluar me tufa të përdredhura flokësh të holluara nga maja, që është njëra ndër karakteristikat kryesore të paraqitjeve figurative të kësaj perëndie⁵⁰, ndërsa buzët janë gjysmë të mbyllura, kurse sytë, si në rastin tonë, janë të trajtuar me shikim të prirur përpyetë, që është interpretuar si pasojë e bebëzës së madhe⁵¹. Mirëpo, jemi të mendimit se edhe në këtë rast shkakun duhet kërkuar në trajtimin e trashë të kapakëve të syrit. Kjo kokë nga aspekti ikonografik është plotësisht e ngjashme me bustet e Serapisit me modius nga Museu i Vatikanit dhe Vila Albani të Romës, të cilat merren si kopje romake të origjinalit të njohur të Briaksit në shekullin IV p. Kr. për Ptoleme II Filadelfin⁵². Por, përderisa kjo kokë merret si import nga Aleksandria⁵³, për ekzemplarin tonë, i cili ndryshon nga kopjet e cekura në modelimin e flokëve dhe të buzëve, një gjë e tillë vështirë është të thuhet.

45 V. S. M. Scrinari, vep. cit., 45, nn. 122-124 (nga Akuileja).

46 Lj. Zotović, vep. cit., 104, n. 49. Mirëpo, bazuar në modelimin e mustaqeve ndoshta mund t'i takojë një kohe më të hershme, fillimit të shekullit III, khr. M. Tomović, vep. cit., 96, n. 106.

47 Khr. V. S. M. Scrinari, po aty, 45, n. 121.

48 Po aty, 45, n. 122.

49 V. Sokolovska, *Antička skulptura vo SR Makedonija*, Skopje 1987, 206, n. 196, T. 75, fig. 1.

50 V. S. M. Scrinari, po aty, 45, nn. 123-124.

51 V. Sokolovska, po aty, 206.

52 M. Bieber, *The Sculpture of the Hellenistic Age*, New York 1955, 83, figg. 296-296.

53 V. Sokolovska, po aty, 207.

Mirëpo, megjithë humbjen e saj, mënyra e punimit dhe vendi i gjetjes tregojnë se mund të jetë import nga një qendër tjetër e Lindjes.

Nga dy paraqitjet skulpturore të fundit të këtij grupi statuetash kanë mbetur pjesët e poshtme, përkatësisht bazamentet.

Te njëri ekzemplar, punuar në mermer të bardhë të kualitetit të lartë me dimensione 36cm, kemi të bëjmë me grupin skulpturor të Jupiter Dolikeni në dem, nga i cili ka mbetur vetëm figura e dëmtuar e demit e modeluar natyrshëm me gjurmët e shputave të perëndisë në shpinë⁵⁴ (fig. 9). Demit sot i mungojnë të katër këmbët, e po ashtu edhe koka është mjaft e dëmtuar, ku duken mbetjet e brirëve, ndërsa në fytyrë janë ruajtur sytë të cilët janë modeluar me kapakë në formë gajtani. E ruajtur mirë është qafa shumë e gjatë dhe trupi i shkurtër, por i fortë, me bishtin e shkurtër e të përdredhur i cili duke qenë i ngjitur për trup, është trajtuar në relief të ulët. Nga pozicioni i figurës shihet se demi ka qenë i paraqitur në lëvizje në të djathtë me këmbën e përparme të djathtë të ngritur dhe me kokën e kthyer nga shikuesi.

Ky grup skulpturor, i një pune shumë kualitative, është modeluar sipas skemës së zakonshme⁵⁵ dhe nga aspekti ikonografik është shumë i ngjashëm me grupin nga Egeta (Bërza Pallanka) në Mezi të Epërme, prej së cilës ka mbetur vetëm demi me shputat e perëndisë⁵⁶. Po nga ky vend kemi edhe dy grupe skulpturore të ngjashme, ku te njëra po ashtu ka mbetur vetëm demi me shputat e perëndisë dhe bazamentin, kurse te tjetra edhe figura e perëndisë pa kokë⁵⁷. Me këta ekzemplarë është i ngjashëm edhe grupi nga Acumincum-i (Slankameni) në Panoni të Poshtme⁵⁸, prandaj me siguri të gjitha këto grupe skulpturore janë skalitur sipas modelit të njëjtë. Ndër-kaq, nga Mezia e Epërme kemi edhe një skulpturë demi të gjetur në Vimi-nac, i cili paraqet pjesë të këtij grupi skulpturor⁵⁹.

Në bazë të analogjisë me ekzemplarin nga Egeta, i cili së bashku me ekzemplarët tjerë, është gjetur në një faltore të vogël (sacrarium) të Jupiter Dolikeni⁶⁰, mund të themi se edhe ekzemplari ynë me siguri duhet të jetë skalitur në të njëjtën kohë, në fund të shekullit II dhe në fillim të shekullit III, si dhe pa dyshim vjen edhe nga vendi i njëjtë. Dy fakte – prejardhja e përkushtuesit nga Isauria e Azisë së Vogël në mbishkrimin e bazamentit të

54 N. Vulić, vep. cit., 93, n. 201; E. Dobruna-Salihu, *Plastika dekorative...*, 858, n. 405, T. 187, fig. 350 (me literaturën e cituar).

55 Khr. Ed. Meyer, Dolichenus, *Ausführliches Lexicon der griechischen und römischen Mythologie* 1/1, Leipzig 1884-1886, col. 1193-1194, T. 3/1; S. Reinach, vep. cit., 1897a, 21, nn. 2-5.

56 D. Vučković-Todorović, Svetište Jupiter Dolihena u Brzoi Palanci, *Starinar* 15-16, 1964-65, 1966, 175, fig. 7.

57 Po aty, 173, fig. 4, 175, fig. 6.

58 P. Merlat, *Répertoire des inscriptions et Monuments figures du culte de Jupiter Dolichenus*, Paris-Rennes 1951, 57, T. 4, fig. 1.

59 Po aty, 51, n. 53, fig. 10.

60 D. Vučković-Todorović, po aty., 179-180.

njërit ekzemplar dhe gjetja e të hollave të prera po nga kjo trevë në Kari⁶¹, na shpie që gjithsesi më parë vendin e prodhimit duhet kërkuar në qendrat lindore. Mirëpo, ekziston edhe mendimi se janë punime të skulptorëve të Lindjes në njërën nga punëtoritë lokale, siç ishte ajo e Timak minusit ose bazuar në disa detaje të pa përfunduara të demit, punime in situ, në tempullin e Egetës⁶². Megjithatë, një gjë është e sigurtë, këto janë vepra të skulptorëve të përkryer.

Tek ekzemplari tjetër, punuar po ashtu në mermer të bardhë, para së gjithash me proviencë lindore, në bazamentin me dim. 25cm janë ruajtur vetëm me dy shputa këmbësh të perëndisë në lëvizje me gishtërinj të modeluar qartë: e djathta deri te nyelli, e majta vetëm në pjesën e përparme, pjesa e prapme e së cilës e thyer, ka qenë e ngritur. Pranë këmbës së djathtë gjenden mbetjet e një druri, kurse pranë së majtës figura e një breshke⁶³ (fig. 10).

Për interpretimin e kësaj mbetjeje skulpturore kemi mendime të ndryshme. Më herët është lidhur me Sabazin për shkak të pranisë së breshkës⁶⁴, e cila është njëra ndër atributet kryesore të tij⁶⁵. Më vonë është shfaqur mendimi se nuk mund të lidhet me asnjë perëndi⁶⁶. Mirëpo, në bazë të paraqitjeve analoge statuare, në të cilat Hermesi – Mërkuri është paraqitur bashkë me breshkë, me këtë perëndi e kemi identifikuar edhe këtë ekzemplar. Të ruajtur deri tash në tërësi kemi disa ekzem-plarë me breshkën në mes këmbëve: në njërin, i cili gjendet në Muzeun e Kapitolit të Romës, kjo perëndi në figurë djaloshi në lëvizje, është paraqitur vetëm me breshkën, të cilën ai e shikon ndoshta në një lojë me të⁶⁷, ndërsa tek ekzemplarët e tjerë kjo perëndi është paraqitur në grup⁶⁸. Ndërkaq, në një ekzemplar nga Aurelia Aquensis (Baden – Badeni) në Gali, si në rastin tonë, është ruajtur vetëm bazamenti me mbeturinat e skulpturës, përkatësisht me shputat e perëndisë, që me njërën këmbë shkel breshkën⁶⁹. Mërkurin me breshkën po ashtu e hasim të paraqitur edhe në relief. Një rast të tillë e kemi në një altar nga Epamandu-odus-i (Mandeure), prap në Gali, ku kësaj perëndie i është ruajtur gjysma e poshtme e trupit me mbeturinat e dy duarve; në të djathtën mban qesen, ndërsa pranë këmbës së djathtë gjendet

61 Po aty, 176, fig. 6, 178, 181.

62 M. Tomović, vep. cit., 73.

63 N. Vulić, vep. cit., 94, n. 205; M. Tomović, po aty, 119, n. 203a, fig. 53 1a; Interpretimi: E. Dobruna-Salihi, *Plastika dekorative*, 849, n. 385, T. 178, fig. 330.

64 S. Dušanić, Dve rimske stele iz Srbije, Zbornik Narodnog Muzeja u Beogradu 8, Beograd 1975, 136, shën. 33.

65 T. Eisele, Sabasios, *Roscher's Lexikon* 4, 1909-1915, col. 232 e tutje, col. 245-246, figg. 4-6.

66 M. Tomović, po aty., 119.

67 H. Stuart Jones, *A Catalogue of the Ancient Sculptures preserved in the Municipal Collections of Rome: 2. The sculptures of the Palazzo dei Conservatori*, Oxford 1926, 148, n. 32, T. 53.

68 Khr. S. Reinach, vep. cit., 1897a, 174, nn. 4, 6, 175, nn. 1, 2.

69 E. Espérandieu, vep. cit., 1955, 73, n. 8577, T. 91, fig. 8577.1.

breshka⁷⁰. Një rast tjetër e kemi në një pllakë votive nga Vindelicum-i (Ausburgu) në provincën e Recisë, në të cilën është paraqitur edhe Erosi⁷¹.

Sa i takon vendit të prodhimit, përkundër humbjes së skulpturës, në bazë të modelimit të gishtërinjve dhe të lëvizjes shumë natyrore të këmbëve, mund të themi se është vepër e një skulptori mjaft të talentuar, i cili e ka punuar në ndonjë punëtori të qendrave lindore, ose në punëtorinë lokale.

Përkritazi me përkushtuesit e këtyre statuetae, dedikimet epigrafike të gjetura në mbarë trevën dardane⁷² – pos Venerës – lënë të kuptohet se ata u takonin etniteteve të ndryshme.

Skulptura mbivarrore – është dokumentuar vetëm me dy sarkofagët nga pjesa qendrore dardane: Vendenis-i (Gllamniku) dhe Ulpiana.

Sarkofagu nga Vendeni i takon tipit me kapak në formë çatie në dy ujëra. Është i punuar nga mermeri kristalor me ngjyrë shkëlqimisht të bardhë me rremba gri dhe i ruajtur në tërësi në të dy pjesët: arkë (215 x 98 x 50cm) dhe kapak (220 x 98 x 50cm), pos disa dëmtimeve të vogla dhe një të çareje të thellë të pjerrtë në mesin e pjesës së sipërme të kapakut, me siguri të shkaktuar me rastin e gjetjes⁷³ (fig. 9). Arka është e papërpunuar, pos bazamentit dhe kurorës të profiluara në tri anë. Ndërkaq, kapaku është i pajisur me akroterët e mëdhenj këndorë, prej të cilëve vetëm njëri në njërin faqe anësore është i zbukuruar me motivin e gjysmëpalmetës së stilizuar dhe tjetri i skicuar me këtë motiv (ky skicim nuk mund të dihet se ku u krye), ndërsa në faqen tjetër ata nuk janë të dekoruar. Në të dy këto faqe, brenda fushave trekëndëshe të profiluara, është skalitur nga një rozetë, ku vetëm njëra është e përfunduar. Kurse njëra anë e tij është e zbukuruar me motivin e tjegullave harkore, të skalitura pa brinjën e zakonshme në mes, e të renditura në formë luspash (squamae), duke përfunduar me një brez të ngushtë të dekoruar me një motiv gjeometrik, ndërsa ana tjetër së bashku me akroterë është e papërpunuar, që të jep përshtypje se nuk është e kryer ose nga kjo anë sarkofagu nuk ka qenë i dukshëm për shikuesin.

70 Po aty, 48, n. 8485, T. 53, fig. 8485,1.

71 F. Wagner, Raetia und Noricum, *Corpus Signorum Imperii Romani (CSIR)*, Deutschland 1/1, Bonn 1973, 49, n. 145, T. 45, fig. 145.

72 Kh. Z. Mirdita, vep. cit.

73 S. Fidanovski, "Poljanice", Glavnik, Podujevo – rimska nekropola, *Arheološki pregled* 24, Beograd 1985 101. Interpretimi: E. Dobruna-Salihu (2008): Kaiserzeitliche reliefgeschmückte Sarkophage aus Dardanien, 171-173, fig. 1; e njëjta, Glavni trgovački antički putovi Kosova u svjetlu kamene plastike, *Routes and Trade from Prehistory to the Early Middle Ages*, International Archaeological Symposium, Pula, 27-29 November 2008, *Histria Antiqua* 17, Pula 2009, 195-196, fig. 2 a, b.

Sa i takon kapakut-çati me akroterë në kënde, ai është trajta më e shpeshtë e të gjitha grupeve lindore të sarkofagëve e cila është një e mirë kulturore shumë e lashtë dhe e përhapur e Mesdheut⁷⁴. Për këtë arsye edhe sarkofagët e këtij lloji i takojnë të ashtuquajturit tip oriental ose i Azisë së Vogël, me të cilin ka herë është marrë studiuesi i këtyre sakofagëve, G. Rodenwaldt⁷⁵. Ky tip mbisundon në Lindje, meqë është më i përhapuri, por që takohet shumë shpesh edhe në Perëndim, kështu që është i zakonshëm edhe në provincat e Ballkanit, ku edhe dominon⁷⁶. Po ashtu edhe në Dardani, pos dy ekzemplarëve, të gjithë të tjerët i takojnë tipit çati⁷⁷.

Nga të gjitha rastet e sarkofagëve të trevës dardane me dekorime në relief të ruajtur në tërësi, apo vetëm të kapakut, kapaku është i dekoruar te të gjithë. Mirëpo, ky dekor është i një natyre krejt tjetër. Kështu, derisa motivi dekorativ i përbërë nga rozeta dhe gjysmëpameta akroteriale haset edhe te ekzemplarët e tjerë⁷⁸, motivi i tjegullave haset për herë të parë prandaj ky sarkofag si i tillë paraqet një ekzemplar unik në këtë trevë. Ndërkaq, ky motiv i cili e imiton kulmin e shtëpisë është i pranishëm si te sarkofagët atikë, ku paraqitet rregullisht ashtu edhe tek ata të Azisë së Vogël. Dallimi në mes tyre, sipas studiuesit të njohur të sarkofagëve të kohës romake, G. Koch, qëndron në formën e tjegullave, ku tjegullat në formë gjetheje si në rastin tonë, janë karakteristike për ekzemplarët atikë, ndërsa tjegullat e ngushta e të gjata dhe imbricis-et e mëdhenj e të sheshtë për ata orientale⁷⁹. Por, marrë në përgjithësi, sarkofagët me një dekorim të tillë të kapakut flasin se ata kanë të bëjnë me modelet atike, apo orientale⁸⁰. Duke u nisur nga fakti se kjo mënyrë dekorimi u përvetësua edhe nga punëtoritë vendëse, këta sarkofagë i hasim në shumë treva të Perandorisë qoftë si prodhime lokale, qoftë si import (Athena, Thessalonica, Antiochia, Efessus, Berytus, qendrat e Italisë së Veriut, etj.)⁸¹, në mesin e të cilave edhe

74 N. Cambi. Antički sarkofazi iz Like. *Arheološka problematika Like*. Znanstveni skup. Otočac, 21-23. rujna 1974. Hrvatsko arheološko društvo 1. Split, 1975. 77-78.

75 G. Rodenwaldt. Sarkophagprobleme. *Mitteilungen des Deutschen Archäologischen Instituts. Römische Abteilung* 57 1-2. Mainz am Rhein 1943. 3 e tutje.

76 Khr. T. Gerasimov. Antični sarkofazi ot Odesos. *Izvestija na Narodnija muzej v Varna* 5 (20). Varna 1969. 60 e tutje. ku jep një pasqyrë të sarkofagëve të Odesit: N. Cambi. Sarkofag iz Šipova. *Godišnjak. Centar za balkanološka ispitivanja ANU BiH* 20 18. Sarajevo 1982. 97.

77 Khr. E. Dobruna-Salihu. *Plastika dekorative...* 794-797. nn. 285-292. figg. 245-251. e njëjta. Kaiserzeitliche. 169-177. nn. 1-9. figg. 1-3.

78 E. Dobruna-Salihu. *Plastika dekorative...* 794-796. nn. 285. 286. 289. figg. 245. 246. 249; e njëjta Kaiserzeitliche. 169-170. 173-174. nn. 1. 2. 5. 6. fig. 2a.

79 G. Koch – H. Sichtermann. *Römische Sarkophage*. Handbuch der Archäologie. München 1982. 371; G. Koch. Sarkophage der römischen kaiserzeit in Albanien. *Monumentet* 1. Tiranë 1988. 73-74.

80 N. Cambi. *Sarkofazi na istočnoj Jadranskoj obali (3-7 st.)*. (Diss.). Zagreb 1975. 173.

81 Khr. G. Koch – H. Sichtermann. po aty. 352. figg. 384-385 (Thesalonikë). 366 e tutje. fig. 454 (Athinë); fig. 509 (Efes); fig. 562 (Bejrut – import atik); N. Himmelmann. Der "Sarkophag" aus Megiste. Mainz-Wiesbaden 1970. TT. 6.15 (Antakjë); H. Gabelmann. Die Werkstattgruppen der oberitalischen Sarkophage. *Beihefte der Bonner Jahrbücher* 34. Bonn 1973. TT. 26. 27; i njëjti. Zur Tektonik oberitalischer Sarkophage. Altäre und Stelen. *Bonner Jahrbücher* 177. 1977. 201. fig. 1 (ekzemplarët e Italisë së Veriut).

në ato ilire. Kështu, në provincën e Dalmacisë janë të pranishëm kryesisht në Salona (Solini), të punuar në mermer prokonez apo gur vendës⁸², ndërsa një ekzemplar është nga Diluntum-i (Stolci) në brendi të kësaj province, i punuar në gur gëlqeror⁸³. Në pjesën perëndimore të provincës së Maqedonisë dhe në pjesën veriore të provincës së Epirit (Shqipëri) kemi katër sish: dy nga Dyrhachium-i (Durrësi), një nga Buthrotum-i (Butrinti) dhe një nga Phoenice (Finiqi), që i takojnë importit atik të gjysmës së dytë të shekullit II⁸⁴. Ndërkaq, si prodhime lokale, të punuar në gur gëlqeror, këta sarkofagë janë të pranishëm edhe me dy ekzemplarë nga Sirmium-i (Mitrovica e Sremit) në Panoninë e Poshtme⁸⁵.

Rreth çështjes së prejardhjes së ekzemplarit tonë – gurorës nga i cili u shfrytëzua mermeri dhe vendpunimit të tij – lloji i mermerit dhe arka me sipërfaqe të vrazhdë, e papunuar fare, tregojnë se ky sarkofag duhet të jetë punuar nga mermeri prokonez, i cili nxirrej në guroret e njohura të Proconnesus-it (ishullit të Mermerit në detin Marmara), prej nga u eksportua si bllok vetëm me kontura, ndërsa në vend – in situ filloi përpunimi i tij lokal⁸⁶. Kjo u arrit më shumë në kapak, kurse nga arka vetëm bazamenti dhe skaji i sipërm me profile. Një eksport të tillë të sarkofagëve prokonez të papërpunuar, qoftë vetëm të blloqeve me kontura, qoftë vetëm me motive të skicuara, të cilët pastaj punoheshin në punëtoritë lokale, e hasim në të gjithë Perandorinë Romake⁸⁷. Një numër i madh i tyre është eksportuar në pjesën bregdetare të provincës së Dalmacisë, me qendër në Salonë, të cilët në bazë të gjendjes në të cilën janë bartur merren si prodhime lokale⁸⁸. Ndërkaq, shikuar nga stili i punimit të pjesëve të kryera, që janë të një cilësie të lartë, ky sarkofag më parë duhet të jetë punuar nga një mjeshtër i shkathët i huaj, i cili sipas të gjitha gjasave, me kërkesën e porositësit (blerësit) kishte ardhur së bashku me sarkofagun e papërpunuar

82 F. Bulić, Due coperchi di sarcofagi marmorei trovati a Salona, *Bulletinodi archeologia e storia dalmata* (BASD) 30, Split 1907, 99-101, TT. 5-6; i njëjti Escavi nella necropoli antica pagana di Salona detta Hortus Metrodori negli anni 1909 e 1910, BASD 33, 1910, 54; N. Cambi, Sarkofazi na istočnoj..., 408; E. Višić-Ljubić, Poklopac sarkofaga od prokoneškog mramora iz Salone, *Opuscula Archaeologica* 23-24, Zagreb 1999-2000, 459 e tutje, fig. 1.

83 D. Sergejevski, Rimski spomenici iz Bosne, *Spomenik Srpske kraljevske akademije* 77 (60), Beograd 1934, 23-24, n. 36.

84 G. Koch, Sarkophage der römischen..., 73-74, nn. 13-14, figg. 27-28; f. 76, nn. 22-23, figg. 41-42. Te sarkofagu n. 13 ka gjasë që tjegullat të jenë punuar në vend në imitit të atyre të Azisë së Vogël, khr. 73.

85 A. Ceramanović-Kuzmanović, Die dekorierten Sarkophage in den römischen Provinzen von Jugoslawien, *Archaeologia Iugoslavica* 6, Beograd 1965., 102, nn. 30, 33, TT. 8, 9, figg. 25 a, d, 28 a; V. Dautova-Ruševljan, *Rimska kamena plastika u jugoslovenskom delu provincije donje Panonije*, Novi Sad, 1983, 198, T. 26, 1A, T. 27, 1A.

86 Këtë konstatim gojarisht ma ka sugjeruar prof. dr. G. Koch-u nga Universiteti i Marburgut në Gjermani të cilit me këtë rast i falenderohem.

87 Khr. H. Wiegartz, Marmorhandel. Sarkophagerstellung und Lokalisierung der kleinasiatischen Saulensarkophage, *Mélanges Mansel I*, Ankara 1974, 369; G. Koch, Sarkophage der römischen..., 39; i njëjti, Grabdenkmäler der römischen kaiserzeit in Albanien, *Iliria* 19/2, Tiranë 1989, 160.

88 N. Cambi, *Atički sarkofazi na istočnoj obali Jadrana*, Književni krug, Split 1988, 15.

për ta punuar në vend, që sipas studiuesit të sarkofagëve prokonez, J. B. Ward-Perkins, praktikohet të sarkofagët e tillë⁸⁹. Kurse sipas formës së tjegullave ky mjeshtër para vetës duhet të ketë patur një model të sarkofagut atik, për çka flet edhe brezi i zbukuruar, që haset shpesh të sarkofagët e kësaj qendre⁹⁰, e që në rastin tonë motivi i këtij brezi është vendës. Sipas modeleve atikase është punuar shumica e sarkofagëve të tillë nga mermeri prokonez apo guri gëlqeror vendës edhe në provincën e Dalmacisë⁹¹. Modelet atikase po ashtu u përvetësuan edhe nga disa punëtorë të Azisë së Vogël⁹². Sarkofagë që kopjojnë dekorimin e një qendre tjetër që s'ka të bëjë me qendrën nga i cili u shfrytëzua mermeri kemi edhe gjetiu, i tillë është një sarkofag atik gjysmë i gatshëm nga Dyrrahu, te i cili gjatë përpunimit të kapakut në punëtorinë lokale, në skalitjen e tjegullave janë imituar kapakët e Azisë së Vogël⁹³.

Megjithëse sarkofagë prokonezë të papërfunduar – me pjesë të pakryera apo të papunuara – hasim edhe gjetiu, të cilët janë të lidhur me aftësitë e punëtorëve lokale⁹⁴, në rastin tonë shkak i mospërfundimit të sarkofagut duhet të jetë i lidhur me përdorimin e tij të parakohshëm. Koha e punimit të tij, në bazë të stolive të gjetura në sarkofag⁹⁵, duhet t'i takojë shekullit IV. Ky datim është në pajtim me përdorimin e tërësishëm të sarkofagëve të këtij eksporti, i cili duke përfshirë një hapësirë të madhe: Mesdheun Lindor, brigjet e Pontit, provincat danubiane me koncentrim në Traki, brigjet e Adriatikut dhe të Gadishullit Apenin, me koncentrim në Dalmaci dhe Italinë Veriore⁹⁶, kap një interval kohor prej fillimit të shekullit III deri në fund të shekullit VI⁹⁷.

Sarkofagu nga Ulpiana i takon tipit me kapak-kline. I punuar në mermer të bardhë kristalor të kualitetit të lartë me kokrriza të mëdhenj paraqet një punë mjaft cilësore. Është i tëri dhe pos dëmtimeve të vogla në arkën e përmasave të mëdha (236 x 128 x 121 cm.) dhe të skajeve të kapakut (256 x 149 x 60cm), ishte i ruajtur deri në marsin e vitit 2008 kur

89 J. B. Ward-Perkins. The Imported Sarkophagi of Roman Tyre. *Bulletin du Musée de Beyrouth*. 1969. 109 e tutje.

90 Khr. G. Koch – H. Sichtermann, vep. cit., TT. 419, 429, 460; G. Koch, Sarkophage der römischen..... 73-74, n. 13, fig. 27, f. 76, n. 23, fig. 42, f. 77, n. 29, fig. 51.

91 Shih.: shën. 82.

92 G. Koch, Sarkophage der römischen Kaiserzeit in der Türkei. Ein Überblick (mit einer Bibliographie). Adalya 13. *Antalya* 2010, 154, fig. 7 (nga Dokimeioni në Firence), 162, fig. 27 (gjysmëfabikat i Prokonezit në Muzeun e Efesit).

93 G. Koch, Sarkophage der römischen.....73-74, n.13, fig. 27.

94 G. Koch, po aty, 69; N. Cambi. *Atički sarkofazi*. 67 (sarkofagu "Dobrog pastira").

95 Khr. F. Peja. Disa zbulime arkeologjike të periudhës antike në luginën e Llapit. *Trashëgimia etnokulturore dhe historike e Llapit*. Materiale nga Sesiioni shkencor i mbajtur në Prishtinë më 6-17. Nëntor 1993. Prishtinë 1995, 71.

96 Khr. punimet e J. B. Ward Perkins dhe H. Wiegartz.

97 N. Cambi, *Sarkofazi na istočnoj*. 407, 516-518.

ju thye kapaku, i cili u renovua pas dy vite⁹⁸ (fig. 10). Ai qarkohet nga një kornizë e gjerë e profiluar dhe në të tri anët është i rrethuar me një shirit të gjerë konkav, që ngritet mbi bazamentin e tij, duke formuar brenda një hapësire në trajtë shtrati, në njërën anë të të cilit është skalitur jasteku. Arka e ka bazemtin e gjerë dhe të profiluar, që sipas konstruktit i përgjigjet atij të sarkofagëve me kapak çati. Një gjë e tillë tregon se arka dhe kapaku nuk i takojnë njëri-tjetrit, meqenëse arka pa dyshim u mbarua për kapak-çati, por më vonë atij iu dha forma kline. Sarkofagët e tillë hasen edhe gjetiu⁹⁹.

Tipi i sarkofagut me kapak-kline është i përhapur në treva të ndryshme të botës antike, si në Azi të Vogël, Maqedoni, Eubejë, Etruri, ku kemi edhe ekzemplarët më të vjetër, për ç'arsye edhe këtu kërkohet prejardhja e tij¹⁰⁰. Në Romë fillojnë të paraqiten në fillim të periudhës Perandorake, e më të shpeshtë janë nga koha e Hadrianit¹⁰¹. Në Athinë paraqiten më vonë, nga viti 180, që rreth vitit 200 të bëhen të zakonshëm¹⁰².

Është karakteristike se ekzemplari ynë nuk ka kurrfarë paraqitje figurative apo dekorative në arkë dhe kurrfarë figure të skalitur në kapak, ku zakonisht është i shtrirë një person apo çifti bashkëshortor¹⁰³. Prandaj, në pamje të parë do të mendonim se sarkofagu është i pakryer, sidomos kur në një anë, siç pamë sarkofagët nga guroret dhe punëtoritë e Prokonezitet eksportoheshin edhe si gjysmëfabrikate me motive dhe skena të skicuara, e pastaj nga aftësitë e punëtorive vendëse varej përfundimi i motiveve dekorative dhe i skenave figurative¹⁰⁴. Sarkofagë të tillë praktikonin edhe disa gurore dhe punëtori, në mesin e të cilave shquhen ato të Aphrodisias në Azi të Vogël¹⁰⁵. Në anën tjetër edhe te sarkofagët e eksportuar atikë portetet në kline zakonisht vetëm janë skicuar në punëtori, kështu që në shumë raste kanë ngelur në atë gjendje¹⁰⁶. Mirëpo, në mesin e këtyre sarkofagëve ka edhe sish, te të cilët në kapak, pos jastëkut nuk është skalitur kurrfarë figure. Nga trevat e afërta, një ekzemplar të tillë nga shekulli III vjen nga Salona, i cili gjendet në Muzeun Arkeologjik të Splitit¹⁰⁷, kurse nga trevat

98 E. Čerškov, Ulpiana, *Glasknik Muzeja Kosova i Mmetohije 1*, Prishtinë 1956, 322, 324, fig. 4. Interpretimi: E. Dobruna-Salihu, *Kaisezeitliche...*, 178-179, fig. 4; e njëjta, *Glavni trgovački...*, 196-197, fig. 3 a, b.

99 Lidhur me ndryshimet e përgjithshme në arkë, duke u nisur nga fakti se ato nuk aplikohen rregullisht, atëherë këta sarkofagë nga aspekti formal janë edhe të përzier, khr. G. Koch – H. Sichtermann, vep. cit., ff. 371-372.

100 W. Altmann, *Architektur und Ornamentik der antiken Sarkophage*, Berlin 1902, 31, figg. 9-12.

101 W. Altmann, po aty, 41; H. Wrede, *Stadtrömische Monumente. Urnen und Sarkophage des Klintentypus in den beiden ersten Jahrhunderten n. Chr.*, *Archaeologischer Anzeiger (AA)*. Beiblatt zum JDAI 3, Berlin 1977, 395, figg. 70, 109, 110.

102 G. Koch – H. Sichtermann, vep. cit., 371; N. Cambi, *Atički sarkofazi...*, f. 24.

103 G. Koch – H. Sichtermann, po aty, f. 371.

104 H. Wiegartz, vep. cit., 369; N. Asgari, *Die Hallfabrikate kleinasiatischer Girlandensar-ko-phage und ihre Herkunft*, *Zweites Symposium über die Antiken Sarkophagreliefs*, AA 3, 329 e tutje; G. Koch – H. Sichtermann, po aty, 382, 486; G. Koch, *Sarkophage der römischen...*, 69.

105 G. Koch – H. Sichtermann, po aty, 495 e tutje; N. Cambi, vep. cit., 16.

106 G. Koch – H. Sichtermann, po aty, 373; N. Cambi, po aty, 26.

107 N. Cambi, *New Attic Sarcophagi from Dalmatia*, *Grabeskunst der römischen kaiserzeit*. Herausgegeben

e largëta na është i njohur një sarkofag i cili ruhet në Muzeun Shtetëror të Bejrutit¹⁰⁸, me ndryshime në trashësinë e kapakut dhe të zburimeve relievo në arkë – te i pari me paraqitje figurative, ndërsa te i dyti me një motiv të thjeshtë gjeometrik. Në bazë të analogjive me këta ekzemplarë mund të konstatojmë se sarkofagu ynë nuk paraqet vepër të papërfunduar, por është plotësisht i kryer, meqë skalitësi me qëllim në shtrat nuk e ka skalitë figurën apo figurat e zakonshme, ashtu si edhe dekorimin në arkë, aq më shumë kur nuk ka kurrfarë shenjash të motiveve, përkatësisht figurave të skicuara, meqë ato kurrë nuk kanë qenë të parapara të skaliten, por përkundrazi, sipërfaqja ka një zmat të theksuar.

Përkundër krahasimit me këta dy ekzemplarë sarkofagësh të importit atik, lloji i mermerit nuk flet se kemi të bëjmë me një import të tillë, por sipas vlerësimit të G. Kochut duhet të jetë import i Azisë së Vogël¹⁰⁹. Mirëpo, sipas analizës petrografike të mermerit të realizuar nga W. Prochaska, del se 42, 8 % ky mermer është i provienencës së ishullit Paros në Egje¹¹⁰, që, meqenëse pjesa tjetër e mermerit mbetet e panjohur, tregon se analiza e tij duhet përsëritur. Te ky sarkofag një gjë është e evidente, me llojin kualitativ të mermerit, përmasat e mëdha dhe punimin e përkryer paraqet vepër monumentale aty rreth vitit 250. Po ashtu paraqet ekzemplarë të rrallë me kapak-kline në Dardani, ku, kapak të tillë duhet të ketë pasur vetëm edhe sarkofagu i fragmentuar nga Naisi që i takon importit atik¹¹¹, i cili nga zbulimet e deritashme paraqet rastin e dytë në Dardani. Deri sa ky sarkofag duhet të ketë arritur nga një rrugë tjetër, sarkofagu i Ulpianës ka arritur përmes rrugës së njëjtë me sarkofagun e Vendenit, si kundër edhe sarkofagu prokonez nga Viminaci i cili paraqet ekzemplarin e vetëm me kapak-kline në pjesën veriore të Mezisë së Epërme¹¹².

Sa u takon mbartësve të këtyre sarkofagëve, për atë nga Vendeni, stilit të kualitetit të lartë të punuara në ar dhe gur gjysmë të çmueshëm, flasin se kemi të bëjmë me një vajzë të re e cila u varros së bashku me to, duke dëshmuar se ajo i takonte shtresës së lartë qytetare. Po ashtu, edhe për sarkofagun e Ulpianës, përkundër plaçkitjes së mëhershme, për ç'arsye çifti bashkëshortor i varrosur në të u gjet pa stoli, vet kualiteti i lartë i punimit dhe përmasat flasin se kemi të bëjmë me përfaqësues të shtresës së lartë qytetare. Mirëpo etniteti i tyre në të dy rastet nuk mund të

von Guntram Koch. Mainz am Rhein 1993. 77-85. TT. 30-33.

108 G. Koch, *Sarkophage der römischen Kaiserzeit*, Darmstadt 1993. 152, fig. 53.

109 Këtë mendimi prof. dr. Kochu e ka dhënë në Simpoziumin Ndërkombëtar në Grac në korrik 2008, ku prezantova sarkofagët e Dardanisë.

110 Falenderoj prof. dr. W. Prochaska-n nga Universiteti i Leobenit në Austri, i cili pati mirësinë të më dalë në ndihmë në realizimin e analizës petrografike të mermerit nga një fragment i ofruar në Marburg të Gjermanisë me rastin e Simpoziumit Ndërkombëtar të Sarkofagëve në tetor 2010, ku isha pjesëmarrëse.

111 Shih shën. 7.

112 G. Rodenwaldt, vep. cit., 16, fig. 7; M. Tomović, Prokoneski sarkofag sa giralndama iz Viminaciu-ma, *Viminacium* 6, Požarevac 1991, 61-80, figg. 1-2.

dihet në mungesë të mbishkrimit, i cili te sarkofagët me dekorime në relief zakonisht duhet të ketë qëndruar në arealin e varrit ose në një vend tjetër të dukshëm.

Në fund mund të themi se, këto monumente skulpturore edhe pse në numër të vogël, flasin në të mirë të rëndësisë së rrugës lumore të Danubit në Dardani për import nga Azia e Vogël të skulpturës dhe blloqeve të mermerit për punime të skulpturës në punëtoritë vendore. Është për t'u besuar se këso gjetjesh do të ketë ende.

Prof.dr. Exhlale DOBRUNA-SALIHU

SUMMARY

THE IMPORTANCE OF THE DANUBE RIVER FOR THE IMPORT OF SCULPTURES IN DARDANIA FROM ASIA MINOR

In spite of the fact that the Danube does not flow through Dardania, from the point of view of river traffic during the Roman period, the navigation route of this river certainly played a particularly important role. The Danube was connected with Dardania through the Margus (Morava) and Timachus (Timok) rivers. It played a prominent role for this area in the import of sculpture and marble blocks not only from Asia Minor but also from other Mediterranean areas. This comes most to the fore in the north Dardanian centres: in the settlement and station Timacum minus (Ravne), connected with the Danube via the Timachus river (the White Timok and the Great Timok) – another river important for transport – and the municipium Naissus (Nis), which was connected through that same route, as well as through the Margus river. Another way that both centres were connected was through the road Naissus-Ratiaria, but the import was done through river route. Marble from Asia Minor was imported to the area of Naissus for the manufacture of a number of cult sculptures of local and Greco-Roman pantheons (Fig. 1-2), whereas from another territory, Egypt, there were imported three sculptures in porphyry which were transported through the Mediterranean and the Black Sea. Taking into consideration that the Greeks transported marble also on wagons, the sculptures found in this centre that were made of Greek (Attic) marble, because it is possible that it was imported through a shorter route – by sea to Thessaloniki and then by the road Thessaloniki-Scupi-Naissus. Timacum minus yielded a group of cult sculptures of Oriental and Greco-Roman pantheons (Fig. 3-8), found in the Dolicheneum near the castrum. Based on the type of marble, by and large from Asia Minor, the group was probably imported from there, or was crafted in local workshops. From the central part of the Dardanian area, the same provenance is presumed for two imported sarcophagi – a semi-finished import of Proconnesus marble from the settlement and station Vendenis (Gllamnik) (Fig. 9), and a finished one from Ulpiana (near Prishtina) (Fig. 10).

These monuments, which belong to two thematic groups: cult and sepulchral – of excellent stone from the famous quarries of the Asia Minor, are mostly high-quality works – either imports (in most cases), or local products (more rarely) – mostly from the end of the 3rd and the beginning of the 4th c.